



CIMC- 2006/3
28 gusht 2006

Politika e Këshillit të KPM-së në hartimin publik të rregullave

Preambula

Kjo Rregull mbi hartimin publik të rregullave është miratuar nga Këshilli i KPM-së sipas autoritetit të Ligjit mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim. Qëllimi i saj është të siguroj transparencë, paanësi dhe drejtësi të procesit për krijimin e rregullave për mediat në Kosovë.

Neni 1. Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregulle zbatohen përkufizimet në vijim:

- 1. Rregullat** – çdo rregullore e detyrueshme e lëshuar nga KPM-ja e aplikueshme ndaj personave fizik dhe juridik që janë subjekt i rregullores sipas Ligjit mbi KPM-në dhe Transmetim. Shkelja e Kodeve të KPM-së është subjekt i sanksioneve sipas autoritetit të Ligjit mbi KPM-në dhe Transmetim.
- 2. Kodi** – Çdo varg i parimeve etike dhe obligimeve të lëshuara nga KPM-ja të aplikueshme ndaj përmbajtjes së transmetimit. Shkelja e kodeve të KPM-së është subjekt i sanksioneve sipas autoritetit të Ligjit mbi KPM-në dhe Transmetim.
- 3. Udhëzimet** – çdo udhëzim jo i detyrueshëm, shpjegim apo instruksion i lëshuar nga KPM-ja për të qartësuar përmbajtjen dhe aplikimin e çdo Rregulle apo Kodi të KPM-së.

Neni 2. Qarkullimi i Rregullave, Kodeve dhe Udhëzimeve të propozuara

KPM do t'i njoftojë të licencuarit dhe mediat tjera me të gjitha draft propozimet për Rregulla, Udhëzime dhe Kode me qëllim të nxitjes së komenteve para miratimit të tyre nga KPM-ja. Draft Rregullat, Udhëzimet dhe Kodet do të publikohen në web-faqen e KPM-së në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, dhe të licencuarit dhe mediat tjera do të njoftohen për këtë publikim. KPM-ja gjithashtu mund t'iu dërgoj draft propozimet e tilla palëve tjera të interesuara.

Nëse rrethanat e jashtëzakonshme urgjente siç përcaktohen nga Këshilli i KPM-së parandalojnë një dërgim të tillë paraprak, rregullat apo udhëzimet do të dërgohen sa më parë dhe komentet nga mediat aty ku është e mundur do të mirren në konsiderim gjatë rishikimit të Rregullave, Udhëzimeve dhe Kodeve.

Neni 3. Periudha për Komente

Të licencuarve dhe palëve tjera të interesuara do t'i ipet kohë e arsyeshme, zakonisht 14 ditë, për të parashtruar çfarëdo komenti në draft propozime siç specifikohet nga një afatë i dhënë në kohën e publikimit të tyre. Komentet mund të parashtrohen me shkrim apo postë elektronike apo çfarëdo forme tjetër që KPM-ja mund ta përshkruaj kur dërgon draftin. KPM-ja do t'i shqyrtojë me vëmendje të duhur komentet e pranuar.

Neni 4. Seancat Publike

KPM-ja, si një alternativë apo një shtesë e dërgimit të draft propozimeve, mund të organizoj seanca publike për të licencuarit apo palët tjera të interesuara për të diskutuar propozimet. Mundësitë praktike për numrin maksimal të të licencuarëve dhe palëve tjera të interesuara për pjesëmarrje në seanca të tilla për arsye gjeografike dhe arsye tjera do të merren parasysh kur seancat të organizohen.

Neni 5. Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore do të aplikohet nga 29 gusht 2006.